

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr. _____ prot

Datë 02.11.2018

Për: "A.L-ASFALT" Sh.p.k , adresa Durrës Komuna Xhafzotaj.

Procedura e prokurimit: "Procedurë e hapur" me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-83506-08-22-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës : "Ndërtimi i linjës së transmetimit dhe depos së ujit në fshatin Drenovë", me kohëzgjatje kontrate: 15 javë nga dita e lidhjes së kontratës .

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 34, datë 27.08.2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X çmimi më i ulët dofta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatoreve "NIKA" Sh.p.k , NUIS: J76705047U + "NDREGJONI" Sh.p.k , NUIS: K31329048I, vlara: 16.163.413 (gjashtëmbëdhjetë milionenjëqind gjashtëdhjetëetremijë e katërqindetrembëdhjetë) lekë
2. "A.L-ASFALT" Sh.p.k , NUIS: K81511508A , vlara: 16.183.803 (gjashtëmbëdhjetë milionenjëqindetëdhjetëetremijëetëtetëqindetë) lekë
3. "EGLAND" Sh.p.k , NUIS: J96829419D , vlara: 16 666 795 (gjashtëmbëdhjetë milionegjashtëqind gjashtëdhjetëegjashtëmijëeshtatëqindenëntëdhjetëepesë) lekë
4. "B-93" Sh.p.k, NUIS: J62903508R, vlara: 16.814.779 ((gjashtëmbëdhjetë milionetëtetëqindekatëmbëdhjetëmijëeshtatëqindeshstatëdhjetëenëntë) lekë
5. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "XHENGGO" SHPK, NUIS: J64103171M + "CURRI" Sh.p.k, NUIS: J67902718S, vlara: 18.785.928 (tetëmbëdhjetë milioneshstatëqindeshstatëqindetëdhjetëepesëmijëenëntëqindenjëzetetë) lekë
6. "MANE/S" Sh.p.k, NUIS: J64103865K, vlara: 21.571.761,3 (njëzetënjë milionepesëqindeshstatëdhjetëenjëmijëeshtatëqind gjashtëdhjetëenjëpresjetë) lekë
7. "LALA" Sh.p.k , NUIS: J76418903B , vlara: 21.621.742 (njëzetënjë milionegjashtëqindenjëzetënjëmijëeshtatëqindedyzetë) lekë
8. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "AVDOLLI" Sh.p.k , NUIS: K14721001P + "ALMO KONSTRUKSION" Sh.p.k , NUIS: J91915001P + "VASHTËMIA" Sh.p.k NUIS: J64103054Q, vlara: 22.025.408 (njëzetëdmilionenjëzetepesëmijëekatëqindetë) lekë
9. "ALEN - CO" Sh.p.k NUIS: K83213401M, nuk paraqiti ofertë ekonomike

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i Operatoreve "NIKA" Sh.p.k , NUIS: J76705047U + "NDREGJONI" Sh.p.k , NUIS: K31329048I, vlara: 16.163.413 (gjashtëmbëdhjetë milionenjëqind gjashtëdhjetëetremijë e katërqindetrembëdhjetë) lekë
2. "EGLAND" Sh.p.k , NUIS: J96829419D , vlara: 16 666 795 (gjashtëmbëdhjetë milionegjashtëqind gjashtëdhjetëegjashtëmijëeshtatëqindenëntëdhjetëepesë) lekë

3. " ALEN - CO" Sh.p.k NUIS: K83213401M, nuk paraqiti ofertë ekonomike

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

➤ Lidhur me Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "NIKA" Sh.p.k + "NDREGJONI" Sh.p.k , KVO , në mbështetje të nenit 46 të Ligjit Nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me ndryshime, të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Nenit 66 , pika 3 , vendosi që ofertuesi Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "NIKA" Sh.p.k + "NDREGJONI" Sh.p.k të mos kualifikohet sepse:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk përmbush Kriterin e përgjithshëm të kualifikimit , lidhur me përcaktimin në Marrëveshjen noteriale , të të gjithë elementëve konkrete të punëve që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, në kundërshtim me enin 74 të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 i cili përcakton se:

" Neni 74

Bashkimi i operatorëve ekonomikë

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. "

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike paraqiti:

Akt- Marrëveshje noteriale , datë 08.10.2018, për bashkëpunimin e përkohëshme midis shoqërive Bashkimit të Operatoreve Ekonomike "NIKA" Sh.p.k + " NDREGJONI " Sh.p.k , në të cilën përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes në realizimin e objektit të tenderit në masën: 40,9 % "NIKA" Sh.p.k dhe 59,1% " NDREGJONI " Sh.p.k, si dhe pjesët konkrete të punëve që do të kryejë secili subjekt:

"NIKA" Sh.p.k do të kryejë:

Linjën e Ujësjellësit nga burimi i Ujit të Ftohtë deri në rezervuarin V-100 m3, zërat germim dhe mbushje.

" NDREGJONI " Sh.p.k do të kryejë: Rikonstruksion i kaptazhit të burimit të Ujit të Ftohtë; Rezervuarin e Ujit V-100 m3; zërat e mbetura në "Linja e Ujësjellësit nga burimi i Ujit të Ftohtë deri në rezervuar".

Por në Akt- Marrëveshje noteriale nuk përcaktohet kryerja e punimeve për rikonstruksionin e kaptazhit të burimit të Izvorit, punime të cilat janë këkuar nga AK në DT të publikuara.

2. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk përmbush Kriterin e veçantë të kualifikimit lidhur me Formularin e Ofertës (Preventivin).

Oferta dhe Preventivi i detajuar i paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomike, nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara DT sepse **në preventiv nuk përfshihen punimet për rikonstruksionin e kaptazhit të burimit të Izvorit:**

Nr	An	Pershkrimi i punimeve Rikonstruksioni i kaptazhit të burimit të Izvorit	Njesia	Sasia
1	2.15/a	Germim e mbushjedheukat IV	m3	30.0
2	2.54/2	Mur guri për mbylljen e portes	m3	0.60
3	2.54/2	Mur guri për biratdhekapaket	m3	1.50

3	3.178	Mbushje me argjilembikaptazh	m3	37.5
3	3.178	Mbushje me argjile ne murinanesor	m3	15
6	2.264	Shtresellustercimentonedysshemedhemure 2 cm	m2	15.05
7	3.331	Gabiona me gure me rrjeteteli 1x1x1m	m3	30
8	4.121/4	F.V. saracineskaceliku me flanaxha, DN-100 PN-10	cope	2
9	PC/100	F.V. pjeseç'montuese, DN-100 PN10	cope	2
10	F100	F.V. flanaxhainoxcift DN-100 PN-10	cope	8
12	4.121/4	Koshthithje DN-100	cope	1.0
13	4.59	Tub celiku DN-108x4mm, L=15 m	kg	162.8
14	4.61	T-iceliku DN-100, cope 1	kg	2.5
15	4.61	Brrylceliku DN-100, cope 4	kg	10.0
16	4.61	Hinkeceliku DN-100/150 H-20 cm cope 1	kg	3.1
17	4.61	Tub ajrimi, tub celiku DN-100 -120 cm + 2 brryla DN-100	kg	15.0
18	KP1	Llamarineinoksi 1.1*1.1m, t-2mm , cope 2	kg	37.99
19	KP2	Profilametalikekapakun 1.1*1.1m cope 2	kg	54.00
20	2.37/3b	Transport materiale me kafshe, deri 3.0 km	Ton	1.29

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me DT refuzohen si të papranueshme.

➤ Lidhur me operatorin ekonomik " EGLAND " Sh.p.k , KVO, në mbështetje të nenit 46 të Ligjit Nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me ndryshime, të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Nenit 66 , pika 3 , si dhe të Rekomandimit të APP-së Nr.8197 prot, datë 03.09.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime" vendosi që ofertuesi " EGLAND " Sh.P.K të mos kualifikohet sepse:

1. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pika 8, Shtojca 11 e DT, lidhur me Çertifikatën e vlefshme për Sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 .

Për këtë kriter "Egland" Sh.p.k paraqiti Çertifikatën ISO 14001:2004, në të cilën përcaktohet që afati i fundit për kalimin në ISO 14001:2015 është data 15.09.2018. Pra "Egland" Sh.p.k duhet që brenda datës 15.09.2018 të kalonte në ISO 14001:2015, gjë që nuk e ka bërë.

Rekomandimi i APP-së Nr.8197 prot, datë 03.09.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime" përcakton se:

"APP ka konstatuar se, autoritetet kontraktore përcaktojnë në dokumentat e tenderit, kriterin e paraqitjes nga operatorët ekonomikë të certifikatave:

a. ISO 9001:2008, për sistemet e Menaxhimit të Cilësisë.

b. ISO 14001:2004, për sistemet e Menaxhimit të Mjedisit.

Në vendosjen e këtij kriteri, autoritetet kontraktore nuk marrin në konsideratë faktin se, standardet që këto certifikata përfaqësojnë janë përditësuar, përkatësisht me versionet ISO 9001 :2015 dhe ISO 14001:2015. Certifikatat me standartet e viteve 2008 dhe 2004 janë të vlefshme deri në shtator të vitit 2018.

Pas këtij afati, APP rekomandon që AK të bëjnë kujdes në hartimin e këtij kriteri pasi duhet të kërkojnë në dokumentat e tenderit dhe të pranojnë vetëm standardet e përditësuara të këtyre certifikatave përkatësisht, standartet ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015. "

2. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pika 10, Shtojca 12 e DT, lidhur me pajisjen elektroorganello të kërkuar.

Për këtë kriter "Egland" Sh.p.k nuk ka deklaruar të ketë elektroorganello, tek Shtojca 10 "Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve" , si dhe tek dokumentat e paraqitura për mjetet

dhe makineritë.

➤ Lidhur me operatorin ekonomik "ALEN -CO" Sh.p.k , KVO, në mbështetje të nenit 46 të Ligjit Nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me ndryshime, si dhe të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Nenit 66 , pika 3 , vendosi që ofertuesi " ALEN -CO" Sh.p.k të mos kualifikohet sepse nuk përmbush Kriteret e kualifikimit, të përcaktuar në Shtojcën 11 të DT , për arsye se nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar, por ka paraqitur vetëm një Ekstrakt Historik të Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit, nga Qendra Kombëtare e Biznesit, statusi aktiv.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "A.L-ASFALT" Sh.p.k , adresa Durrës Komuna Xhafzotaj, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 16.183.803 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e tremijë e tetëqind e tre) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKKO Sh.A, Rajoni Nr. 1, Rruga Boris Plumbi, Korçë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 16.814.779 ((gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e katërmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **25.10.2018.**

Ankesa: nuk ka.

* * *

ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Elia Pendavinji